



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 58 pika h.) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të datës 4 qershor 2008 dhe nenit 40 pika h.) të Statutit të Komunës së Lipjanit 15.Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës propozon:

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008 dhe nenit 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15.Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e datës _____ 2026 të miratojë këtë :

PROPOZIM

VENDIM

PËR PËRCAKTIMIN E KOMPENZIMIT TË ANËTARËVE TË KOMISIONIT KOMUNAL TË AKSIONARËVE NË NDËRMARRJEN PUBLIKE LOKALE "PASTRIMI"

I.MIRATOHET , Vendimi për përcaktimin e kompensimit të anëtarëve të Komisionit Komunal të Ndërmarrjes Publike Lokale "Pastrimi" të caktuar sipas Vendimit të Kuvendit të Komunës për formimin e Komisionit komunal të aksionarëve 15Nr.020/04-15247 të datës 31.03.2026.

II.Anëtarët e komisionit komunal të aksionarëve do të kompensohen, për çdo muaj sipas pagës së përcaktuar minimale të Ndërmarrjes Publike Lokale "Pastrimi" ku të njëjtit shërbejnë.

III. Mjetet financiare për kompensimin e anëtarëve të Komisionit Komunal të aksionarëve do të merren nga Ndërmarrja Publike Lokale "Pastrimi " ku edhe shërbejnë.

IV. Ky vendim vlen vetëm për anëtarët e komisionit të zgjedhur nga Kuvendi i Komunës , përderisa kompensimin e anëtarit të deleguar nga Kryetari i Komunës këtij të fundit i rekomandohet ta rregulloj me vendim të veçantë.

V.Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Ndërmarrja Publike Lokale "Pastrimi"

VI.Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në Webfaqen e Komunës .

VII. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi shfuqizohet Vendimi për përcaktimin e kompenzimit të anëtarëve të Komisionit Komunal të Ndërmarrjes Publike Lokale "Pastrimi" Nr 15 -020/04-52742 i datës 28.09.2022.

Arsyetim

Me Vendim të Kuvendit të Komunës 15Nr.020/04-15247 të datës 31.03.2026, është formuar Komisioni Komunal i Aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Lokale "Pastrimi" në përputhje me dispozitat e Ligjit për Ndërmarrjet Publike i cili vepron në emër të Komunës në përputhje me dispozitat e Ligjit për Ndërmarrjet Publike dhe Ligjit për Shoqëritë Tregtare në përbërje prej tre anëtarëve një i emëruar nga Kryetari i Komunës dhe dy të emëruar nga Kuvendi i Komunës.

Me këtë Propozim Vendim përcaktohet vetëm kompenzimi i anëtarëve të Komisionit i cili do të zbatohet nga Ndërmarrja Publike Lokale "Pastrimi" ashtu siq ceket në dispozitiv të këtij Propozim-Vendimi.

Në pajtim me dispozitat e cekura ligjore, kërkojmë nga Kuvendi i Komunës miratimin e këtij Propozim-Vendimi.

1Nr. 01-011/01-22267
Lipjan, 15.05.2026

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti

